


Nëse je etiketuar në një foto që nuk të pëlqen, mbaj mend që shumë faqe rrjetesh sociale dhe ndarjesh të fotove mund të të japin mundësinë ta heqësh emrin tënd nga fotot ku je etiketuar. Gjithashtu, mund të zgjedhësh edhe t'i rishikosh postimet ku je etiketuar përpara se ato të postohen te Kohështrirja në Facebook, në seksionin e cilësimeve të privatësisë: [facebook.com/privacy](https://www.facebook.com/privacy).

Nëse je në Facebook dhe nuk ndihesh i qetë në lidhje me ballafaqimin personalisht me një person ose nëse nuk di çfarë t'i thuash saktësisht, Facebook ka një mjet raportimi në rrjetet sociale me disa mesazhe që mund të përdorësh dhe disa mënyra për të marrë ndihmë nga një prind, mësues ose mik i besuar.

Për gjëra më serioze, për shembull nëse bëhet fjalë për një foto ose video pjesërisht ose plotësisht nudo, nëse është shpifje (nuk është e vërtetë dhe dëmton reputacionin tënd) ose nëse po përdoret për të të ngacmuar ose për të të tallur, mund t'i kërkosh faqes ose shërbimit të përdorur për ndarjen e materialit që ta heqë atë. Në të tilla raste mund ta raportosh edhe në polici.

 Nëse gjendesh në një situatë ku një person të kërcënon me ndarjen e një fotoje tënde nudo nëse nuk i jep foto të tjera nudo - duhet të përfshish në këtë çështje një person të besuar në moshë madhore dhe të kontaktosh menjëherë policinë. Kjo është sjellje e papranueshme dhe në shumë shtete është e paligjshme.



Mënyra e përdorimit të mjetit të raportimit në rrjetet sociale

Për të mësuar më shumë në lidhje me raportimin në rrjetet sociale ose raportimin e materialeve abuzive në Facebook, shko te [facebook.com/report](https://www.facebook.com/report)



Mbjaj mend që nuk je vetëm – mund të flasësh gjithmonë me prindërit, një mësues ose këshillues, një person tjetër të besuar në moshë madhore ose të kontaktosh një linjë ndihme për të marrë ndihmë dhe mbështetje.



OFRUAR NGA:



facebook

PËR INFORMACIONE TË MËTEJSHME,
IZITO LIDHJET E MËPOSHTME:

MediaSmarts [mediasmarts.org](https://www.mediasmarts.org)

Qendra e sigurisë së familjes e Facebook
[facebook.com/safety](https://www.facebook.com/safety)

Këshilla për parandalimin e bulizmit
[facebook.com/safety/bullying](https://www.facebook.com/safety/bullying)

Qendra e ndihmës e Facebook
[facebook.com/help](https://www.facebook.com/help)



MENDO PËRPARA SE TË NDASH

Këshilla nga Facebook dhe MediaSmarts



Gjithmonë dëgjojmë që ndarja është veprim i mirë. Dhe, falë teknologjisë, mund të ndajmë idetë, mendimet, fotot dhe videot tona me miqtë tanë dhe me persona të tjerë.

Në shumicën e rasteve, ndarja është veprim i mirë. Por nëse nuk e mendojmë mirë mënyrën e ndarjes, rrezikojmë të lëndojmë veten ose ndonjë person tjetër. Gjithashtu, mos harro që gjërat që ndan me miqtë e tu mund të përfundojnë të ndara me persona të tjerë. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të mendosh përpara se të ndash.



GJËRAT E TUA

Sa herë që ndan gjëra që kanë të bëjnë me ty - qoftë një foto, video ose gjëra personale, siç është numri i telefonit - mbaj parasysh që këto mund të shihen lehtësisht nga persona të cilëve nuk ke dashur t'ia dërgosh.

Gjithashtu, nuk është ide e mirë të ndash kur ndihesh shumë emotiv - pavarësisht nëse je i inatosur, i trishtuar ose i emocionuar. Në fillim qetësohu dhe më pas vendos nëse është vërtet ide e mirë.

Më pas, pyet veten:

- ✓ A dua që njerëzit të më shohin kështu?
- ✓ A mund ta përdorë dikush këtë për të më lënduar? A do të mërzhitesha nëse dikush do ta ndante atë me persona të tjerë?
- ✓ Cila është gjëja më e keqe që mund të ndodhë nëse e ndaj këtë??

Fjalëkalimet nuk janë të përbashkëta: Për ndarjen e disa gjërave duhet të tregohesh shumë i kujdesshëm. Ndonjëherë miqtë ndajnë fjalëkalimet me njëri-tjetrin kur gjithçka shkon mirë, por fatkeqësisht më vonë kjo mund të shndërrohet në një makth.



KËSHILLAT e Facebook-ut:

1

Fjalëkalimet nuk janë të përbashkëta. Mos e ndaj fjalëkalimin tënd me askënd. Për këshilla të tjera sigurie, shko te:

[facebook.com/help/securitytips](https://www.facebook.com/help/securitytips)

2

Kontrollo cilësimet e privatësisë të **facebook.com/privacy**, për të parë se kush mund t'i shohë postimet e tua.

3

Zgjidh mjetin e zgjedhjes së audiencës sa herë që poston në Facebook, në mënyrë që të sigurohesh se po e ndan me audiencën tënde të dëshiruar

Një foto zgjat përgjithmonë: Disa persona mendojnë që ndarja e një fotoje nudo ose seksi me të dashurën ose të dashurin – ose me një person që ata shpresojnë se do të bëhet e dashura ose i dashuri i tij/saj – tregon dashurinë për të ose besimin ndaj saj/tij. Trego më shumë kujdes në këtë situatë dhe mendo – një foto mund të ekzistojë më gjatë se një lidhje.

Mbjaj mend që, nëse dikush të kërkon të ndash një material për të cilin nuk ndihesh i qetë, ke të drejtën të refuzosh. Një person që të dashuron ose të respekton nuk do të të bënte presion ose të të kërcënonte.

Fshirë në pak sekonda, por ndoshta jo e humbur përgjithmonë:

Disa aplikacione ose faqe rrjetesh sociale premtojnë t'i fshijnë automatikisht fotot ose videot pas disa minutash nga shikimi i tyre. Por ka marifete edhe për këtë – shikuesi mund të bëjë një foto ekrani – kështu që sërish duhet të marrësh vendime të zgjuara në lidhje me ndarjen.



GJËRAT E PERSONAVE TË TJERË

Në shumicën e rasteve, kur njerëzit të dërgojnë materiale, ata nuk e kanë problem që ti i ndan ato me persona të tjerë. Nëse nuk je i sigurt për këtë, mendoje dy herë para se ta bësh këtë veprim. Akoma më mirë do të ishte ta pyesje personin që ta ka dërguar nëse e ka problem që ti ta ndash materialin. E njëjta gjë vlen nëse ndan foto ose video në të cilat gjenden persona të tjerë: pyet përpara se t'i etiketosh, t'i ripostosh ose t'ua përcjellësh personave të tjerë.

Nëse dikush ndan me ty një material në të cilin përfshihet dikush tjetër, pyet veten:

- ✓ A e ka menduar ndarjen e këtij materiali personi që ma dërgoi?
- ✓ A ka marrë leje nga personi që gjendet në të?
- ✓ Si do të ndihesh nëse dikush do të ndante një material të ngjashëm ku përfshihem edhe unë?

Mos ua përcill personave të tjerë materialin që ke marrë nëse shpërndarja e tij do ta bënte personin të dukej keq, nëse do ta vinte në siklet ose nëse mund ta lëndojë.

Personi që ta ka dërguar mund ta ketë menduar si shaka, por, kur gjërat shihen nga personi i gabuar, shakatë mund të mos jenë aq gazmore.

Shumë persona – veçanërisht djemtë – nxiten nga miqtë e tyre që të ndajnë foto nudo të të dashurave ose të të dashurve të tyre. T'i rezistosh këtij presioni mund të jetë e vështirë, por duhet të mendosh sesa mund të lëndosh veten dhe të dashurën/dashurin tënd duke iu dorëzuar këtij presioni.



NDREQJA E VEPRIMEVE NË RAST SE SHKOJNË KEQ

Ndonjëherë të gjithë bëjnë zgjedhje të gabuara. Kjo nuk do të thotë që nuk duhet të bësh gjithçka që ke në dorë për t'i ndrequr gjërat.

Nëse ke ndarë një material që nuk duhet ta kishe ndarë, hapi i parë është t'u kërkes personave që ua ke dërguar që të mos e përcjellin tek të tjerët.

Nëse dikush ka postuar një material që i ke dërguar, gjëja e parë është t'i kërkes që ta heqë. **Në fakt, ky veprim është shumë efikas në shumicën e rasteve.** Mos harro që të mos bësh veprime kur je i mërzhitur: prit sa të qetësohesh dhe, nëse është e mundur, fol me personin jashtë linje.

Nëse personi refuzon ta heqë, mos u përpqi të hakmerresh duke ndarë materiale private që të ka dërguar, duke e bezdisur ose duke u bashkuar me miqtë e tu kundër këtij personi.

E para, ky veprim i përkeqëson gjërat pothuajse gjithmonë. Përveç kësaj, sa më shumë që të hakmerresh ndaj këtij personi, aq më shumë mundësi ka që faji për këtë situatë të bjerë edhe mbi ty po aq sa mbi të.

